



Firmoset kredia, BEI jep 50 milionë dollarë

Publikuar më 05/06/2010

Rrugët

Pas shumë negociatash, qeveria shqiptare dhe Banka Europiane e Investimit kanë nënshkruar dje marrëveshjen për financimin e rrugëve dytësore dhe rurale. Bëhet fjalë për një kredi prej 50 milionë dollarësh që do t'i bashkëngjitet fondit total prej 400 milionë dollarësh për ndërtimin e 1500 kilometrave rrugë dytësore. Marrëveshja për BEI-n u firmos nga zv.presidenti Dario Scannapieco, përgjegjës për Italinë, Maltën dhe Ballkanin Perëndimor, si dhe nga Ridvan Bode, ministri i Financave për Shqipërinë. Kjo është kredia më e madhe e akorduar nga BEI për vendin tonë.

Synimi i projektit është përmirësimi i transportit në zonat rurale dhe lehtësimi i transferimit të produkteve bujqësore në tregjet urbane. Ndërtimi i rrugëve besohet se do të sjellë edhe përmirësim në shërbimet arsimore dhe shëndetësore të qeverisë për zonat rurale. Kostoja totale e projektit në zbatim është 140 milionë euro dhe është bashkëfinancuar nga Komisioni European, si dhe nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Programi i rehabilitimit të rrugëve dytësore menaxhohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Banka Europiane e Investimeve është e pranishme në Shqipëri që nga viti 1995 dhe deri më sot ka dhënë kredi të përgjithshme prej 350 milionë eurosh në projekte të ndryshme.

“Ne jemi me të vërtetë të lumtur që po kontribuojmë në këtë program”, tha Scannapieco. “Kjo është një mënyrë e mirë për të ndihmuar Shqipërinë në progresin e saj drejt integritit europian”, – shtoi ai.

Në një deklaratë të veçantë, zyra e shtypit e Kryeministrit Sali Berisha njoftoi se është diskutuar edhe për financimin e projekt-idesë të rrugës Tiranë-Elbasan.